

VENDIM
Nr. 522, datë 13.7.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE “SISTEMI I MENAXHIMIT TË KARTELAVE INFORMATIVE PËR SHËRBIMET PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Sistemi i Menaxhimit të Kartelave Informative për Shërbimet Publike” (këtu e në vijim “SMKISHP”).

2. Institucioni administrues i SMKISHP-së është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (këtu e në vijim “ADISA”).

3. Dhënës të informacionit për SMKISHP-në janë institucionet e administratës shtetërore që ofrojnë shërbimet publike ndaj personave fizikë dhe personave juridikë.

4. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e grumbulluara nga vetë kjo bazë të dhënash, të cilat përfshijnë:

- a) emrin e shërbimit publik;
- b) kodin e shërbimit publik;
- c) klasifikimin e shërbimit publik sipas:
 - i) funksionit;
 - ii) grupit të shërbimeve;
 - ç) përshkrimin e shërbimit publik, i cili përmban:
 - i) kërkesat që duhen plotësuar për marrjen e shërbimit publik;
 - ii) mënyrën e marrjes së shërbimit publik;
 - iii) listën e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e shërbimit (emërtimi i dokumentit 1, emërtimi i dokumentit 2, emërtimi i dokumentit 3);
 - iv) informacion për dokumentin përfundimtar që vërteton marrjen e shërbimit publik;
 - v) afatin e vlefshmërisë së dokumentit përfundimtar që vërteton marrjen e shërbimit publik;
 - vi) përfituesit e shërbimit;
 - vii) kohën e marrjes së shërbimit publik;
 - viii) tarifën e shërbimit publik;
 - ix) informacion për mënyrën e trajtimit të ankesave;
- d) datën e fundit të ndryshimeve;
- dh) formularin e aplikimit për marrjen e shërbimit publik;
- e) kanalet e ofrimit të shërbimit publik.

5. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash, të cilat përfshijnë:

- a) informacionin për organin kompetent që ofron shërbimin publik;
 - b) adresën e organit kompetent që ofron shërbimin publik;
 - c) shërbimet elektronike (këtu e në vijim “e-shërbimet”).
6. Baza e të dhënave të SMKISHP-së shkëmben informacion me institucionet publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me shërbimet që ofrohen bazuar në legjislacionin nëpërmjet Plat-formës Qeveritare të Ndërveprimit.

7. Bazat e të dhënave shtetërore të institu-cioneve përkatëse, nga të cilat SMKISHP-ja merr të dhëna parësore, janë, si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Administratës Publike, HRMIS, informacion për institucionet;
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, RKA, adresat e institucioneve;
- c) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e-Albania GG, e-shërbimet;

ç) Institucione të tjera, me të cilat SMKISHP-ja mund të ndërveprojë dhe që mund të ngarkohen me akte të tjera, ligjore e nënligjore.

8. Niveli i aksesit në bazën e të dhënave të SMKISHP-së është, si më poshtë vijon:

a) Subjektet e përcaktuara në pikën 3 kanë të drejtë vetëm të marrin informacion përmes kanaleve të komunikimit e të ndërveprimit lidhur me të dhënat parësore.

b) ADISA ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave, në rolet:

i) administrator;

ii) raportues;

iii) auditues;

iv) aprovues;

v) lexues të informacionit.

c) Institucionet e tjera shtetërore, që ofrojnë shërbime publike ndaj subjekteve të përcaktuara në pikën 3, kanë të drejtë të lexojnë informacionin, të hedhin të dhënat apo të modifikojnë informacionin vetëm në lidhje me shërbimet publike respektive të institucionit përkatës, i cili më pas miratohet nga ADISA.

9. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i bazës së të dhënave të SMKISHP-së përcaktohen me rregullore të brendshme të institucionit administrues dhe miratohet nga drejtori Ekze-kutiv i ADISA-s, në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

10. Ngarkohet Agjencia e Ofritit të Shërbi-meve Publike të Integruara (ADISA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi